



<b>DATË/A:</b>	<b>27. 11.2014</b>
<b>REFERENC-Ë</b>	<b>1096/2014</b>
<b>PËR/ZA/TO:</b>	<b>OJQ-se Ec ma Ndryshe</b>
<b>PËRMESË:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	<b>Drejtoria Komunale e Arsimit Nexhat Çoçaj</b>
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	<b>Përgjigje</b>

*Në bazë të kërkesës së OJQ-së “Ec Ma Ndryshe” të datës 21 nëntor 2014, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren jep këtë:*

## **PËRGJIGJE**

Në lidhje me shqetësimin tuaj ne si Drejtori Komunale nuk kemi asnjë te dhënë, se dikush nga banorët përreth shkollës është ankuar dhe se u garantojmë që ankesa të tilla nuk kemi pasë përmes shkollës e as përmes DKA-së. Në anën tjetër edhe ne si drejtori jemi në kuadër të këtij kompleksi. Pastaj sa i përket konstatimit të juaj përmes palës ankuese se gjoja instalimi i kësaj ngrohje në këtë shkollë është i vjetërsuar, u sigurojmë se është e dhënë e paqëndrueshme, meqë ndërrimi i kalldajave në këtë shkollë është bërë në vitin shkollor 2013/2013.

Kontrata për riinstalimin e ngrohjes qendrore në SHFMU “Abdyl Frashëri “ Nr. 62213119521 në vlerë prej 97.726 Euro është e nënshkruar më 18.06. 2013 dhe është realizuar sipas projektit. Ky projekt pos ndërrimit të kalldatores së vjetër ka përfshi edhe ndërrimin e gypave dhe të radiatorëve. Falë këtij investimi sot në shkollë kemi ngrohje të mirë e jo si më parë, kur janë bërë shpenzimet për lëndë djegëse e ngrohja ka qenë e dobët. Kalldatorja është e përshtatshme edhe për dru dhe palet, por për shkak të çmimit më të lirë shkolla ngrohet me thëngjill (objekti i vjetër) ndërsa objekti i ri i kësaj shkolle ngrohet me naftë. As vitin e kaluar, kur u fut në punë kalldatorja e re e as këtë vit nuk kemi problem të natyrës që ju e keni cekur dhe sa për dijeni kalldatorja është e ndërtuar së paku 25 metra larg secilës ndërtesë të banimit.

Sa i përket ndërrimit të lëndës djegëse, ne mendojmë për këtë çështje, dhe shpresojmë se do të ndodhë vetëm kur të kemi buxhet të mjaftueshëm, që për lëndë djegëse të paguajmë trefishin e tanishëm e për një gjë të tillë tash për tash nuk kemi mundësi, për shkak të kufizimeve buxhetore.